

Raport i punës për periudhën nga themelimi deri më 16 shtator 2023

Duke mar parasysh faktin që punësimet e para u realizuan para përfundimit të vitit 2022, dhe institucioni zyrtarisht ishte në gjendje të funksionojë normalisht nga dhejtori 2022, dhe në këtë raport janë përfshirë të gjitha rezultatet e arrira deri më 15 shtator 2023.

Për funksionimin e institucionit janë formuar: Bordi drejtues, Këshilli shkencor dhe Këshilli i palëve të përfshira në të cilin bëjnë pjesë përfaqësuesit e të gjithë komunave, sektorit joqeveritar dhe bizneseve lokale, ndërsa Këshilli për kontrollë të punës materiale-financiare është në proces të formimit.

Që nga themelimi janë mbajtur 11 seanca të Bordit drejtues të I.P.P.K Mali Sharr.

Këshillit shkencor i I.P.P.K Mali Sharr ka mbajtur 2 seanca.

Këshilli i palëve të përfshira I.P.P.K Mali Sharr ka mbajtur 1 seancë.

Gjatë vitit 2022 përmes Agjencisë për Administratë është shpallur konkurs për punësim me afat të caktuar dhe të pacaktuar për personel teknik ndihmës dhe konkurs për nëpunës administrativ me afat të pacaktuar dhe janë realizuar 6 punësime të personelit teknik ndihmës, përkatësisht: Udhëheqës i departamentit për përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, Udhëheqës i Departamentit për mbrojtjen e natyrës, Roje i zonës së mbrojtur, Bashkëpunëtor i lartë për çështjet juridike dhe Bashkëpunëtor i ri për IT.

Më datë 15.09.2023 është shpallur konkursi për punësim të ri për 9 persona nga personeli teknik ndihmës dhe 3 persona nëpunës administrativ.

Institucioni funksionon me 4 njësi organizative: Departamenti për çështje juridike, ekonomike dhe të përgjithshme; Departamenti për mbrojtjes të natyrës; Departamenti për shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore; Departamenti për veprimtari alternative dhe edukim mjedisor. Departamenti i fundit ende nuk është formuar, por me punësimet e reja do të krijohet.

Pasqyrë e akteve që janë përgatitur dhe miratuar për funksionimin e institucionit:

- Statuti i institucionit
- Rregullore për sistemimin e vendeve të punës së institucionit
- Rregullore për organizimin të brendshëm
- Plani i sinjalistikës arkivore për 2022 dhe 2023
- Rregullore për punën e bordit drejtues të I.P.P.K Mali Sharr
- Rregullore për komunikim dhe procedura
- Rregullore e punës së Këshillit Shkencor
- Rregullore e punës së Këshillit të Palëve të Interesit
- Plani vjetor i punësimit për 2022 dhe 2023
- Raport mbi planin vjetor të punësimit për vitin 2022

- Planit i miratuar i menaxhimit për Parkun Kombëtar Mali Sharr
- Program vjetor i mbrojtjes së natyrës së Parkut Kombëtar për 2022 dhe 2023,
- Raport mbi Programin Vjetor për Mbrojtjen e Natyrës,
- Plani i menaxhimit të kafshëve të egra,
- Plan operativ vjetor për mbrojtjen nga zjarri i pyjeve për vitin 2023,
- Regjistër i të dhënave për regjistrimin e masës drurore të prerë në një pyll shtetëror me kërcell të ulët nga persona fizikë për nevojat e tyre;
- Raporte mujore për prerjet, shpërndarjen dhe transportin,
- Raporte mujore për dëmtimin e pyjeve,
- Po krijohet një sistem raportimi për shërbimin e diagnostifikimit dhe parashikimit,
- Fonde të buxhetuara të projektit për zhvillimin e planeve të veçanta për menaxhimin e pyjeve,
- Udhëzim për rregullimin e procedurës me rastin e zgjidhjes së kërkesës për miratim për prerjen e llojeve të rralla të drunjve, drunj individual ose grupor, në tokat bujqësore jashtë pyllit,
- Janë përgatitur udhëzime për rregullimin e procedurës për zgjidhjen e kërkesave për miratim për prerje në pyje private,
- Është marrë vendim për ndalimin e shfrytëzimit të natyrës për organizimin e aktiviteteve turistike, skive me ratrak në territorin e Parkut Kombëtar Mali Shar.
- Është marrë vendim për ndalimin e lëvizjes së mjeteve motorike jashtë rrugëve të lejuara në territorin e Parkut Kombëtar Mali Shar.
- Është dërguar kërkesë deri te Qeveria dhe Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për ndërprerjen e marrëveshjeve koncesionare për ndërtimin e dy hidrocentraleve të vegjël në PK Mali Sharr në Leshnicë, Shkumbin 84 dhe Shkumbin 85.
- Është përgatitur uebfaqe funksionale e institucionit si dhe facebook faqe e përditësuar rregullisht.

Aktivite shtesë:

- Janë lidhur më shumë se dhjetë memorandume bashkëpunimi me institucione të tjera, institucione publike, shoqata alpiniste, organizata joqeveritare dhe kërkimore, etj.
- Institucioni merr pjesë në disa grupe kombëtare pune, në disa projekte, por me vëmendje të veçantë për të shmangur buxhetimin e dyfishtë në kërkesat për donacione dhe mbështetje. Siç përcaktohet në Planin e Menaxhimit të Zonës, të gjitha iniciativat që vijnë nga organizatat joqeveritare janë të kanalizuar në drejtim të përmbushjes së planit 10-vjeçar dhe planeve vjetore të punës së institucionit sepse vetëm së bashku mund të arrijmë vizionin dhe qëllimin për Malin Sharr.

Në vitin e kaluar, stafi teknik u angazhua në aktivitete të drejtpërdrejta në lidhje me ruajtjen e natyrës:

- Janë kryer më shumë se 100 patrulla me gjithsej 3067 orë patrullim dhe 67657 km të përshkuar;
- Është bërë inventarizimi i të gjitha objekteve të paregjistruara, duke regjistruar 769 objekte;
- Janë regjistruar 67 m³ dru të prerë ilegalisht;
- Janë përpunuar dhe realizuar mbi 120 kërkesa për leje prerjesh nga pronarë të pronave private në territorin e parkut.
- 2 kompani që organizojnë skijim janë denoncuar për operim të paligjshëm;
- Janë përgatitur dhe vendosur 25 tabela informative;
- Janë përgatitur dhe vendosur 50 tabela informative për parandalimin e zjarrit;
- Janë rikonstruktuar 3 ura në Leshnicë të poshtme;
- Të gjithë punonjësit janë përfshirë në mbi 20 ndërhyrje të zjarrit në pyje;
- Janë mbajtur takime të rregullta me përfaqësues nga komuna të ndryshme në PK;
- 18 ditë trajnim për çdo rojtar.
- Janë organizuar aksione të shumta për pastrimin e mbeturinave;
- Janë mbajtur takime pune për sinkronizim në zonat mbrojtëse dhe roje në terren me PK Sharri nga Republika e Kosovës.
- Janë identifikuar pesë lloje kryesore të habitateve kyçe përmes të cilave do të monitorohet progresi në mbrojtjen e natyrës në vitet në vijim dhe janë vendosur hapat e parë për monitorimin e vlerave natyrore.
- Është siguruar magazinë për ruajtjen e drurit të konfiskuar.
- Janë ripyllëzuar 33 ha dhe këtë vjeshtë po planifikojmë masa shtesë në këtë drejtim.
- Në atarisin e fshatrave Lices, Sellcë dhe Brodec janë vërejtur dëme të mëdha nga zjarret e mëparshme dhe prerjet ilegale, kështu që në koordinim me Inspektoratin Pyjor aktualisht po zbatojmë masa aktive për riparimin e dëmeve, pastrimin e pemëve të dëmtuara dhe si hap tjetër, pyllëzimin.

Si rezultat i përbashkët i punës në terren dhe punës administrative në të cilin janë përfshirë edhe shumë institucione të tjera, janë dorëzuar këto:

- Një kallëzim në MPB Tetovë për gjueti ilegale.
- Një raport në MPB Tetovë për shkatërrim të pyllit.
- Një raport në MPB për prerje të paligjshme të pemëve të reja.
- Një kallëzim në Policinë Pyjore Tetovë për prerje të paligjshme.
- Një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike Tetovë për “Uzurpim të patundshmërive” dhe “Ndërtim pa leje”.
- Një kallëzim në MPB Tetovë për aktivitete të paligjshme në Parkun Kombëtar nga koncesionari i një hidrocentrali të vogël.
- Një propozim për masë të përkohshme në Gjykatën Themelore Tetovë.
- Një kërkesë për paraqitjen e parashtresës për kundërvajtje në Gjykatën Themelore të Tetovës për shkelje sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës lidhur me lëvizjen e mjeteve motorike në zonën e mbrojtjes së rreptë.
- Një informacion për Prokurorinë themelore, Prokurorinë e shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe një kërkesë për veprime të kundërligjshme në Parkun Kombëtar Mali Sharr.

Hapësira për zyra e ndarë nga Qeveria pranë teleferikut në Tetovë ishte hapësirë restoranti dhe kishte nevojë për rindërtim dhe përshtatje të plotë. Për këtë qëllim janë përdorur fondet e donatorëve.

Vështrim i shkurtër në lidhje me financat:

- Është lidhur një marrëveshje granti njëvjeçare me PONT;
- Është nënshkruar një marrëveshje granti katërvjeçar me Global Conservations;
- Është përgatitur dhe miratuar Planin Financiar për vitin 2022 dhe 2023,
- Është përgatitur Llogaria Përfundimtare për vitin 2022 dhe 2023 në Regjistrin Qendror dhe në Administratën e të Ardhurave Publike,
- Është përgatitur raporti për Planin Financiar për vitin 2022,
- Është përgatitur plan për Prokurim Publik,
- Mjetet bazë të punës si uniforma, automjete, kompjuterë, dylbi, pajisje GPS, printera, mobilje zyre etj. janë prokuruar.
- Është rregulluar sistemi i organizuar i pagesave fiskale,
- Është miratuar Tarifa në Bordin drejtues,
- Është përgatitur një program financiar i licencuar dhe i njejtë është vënë në përdorim,
- Buxheti me të cilin disponon I.P.P.K. Mali Sharr nga formimi i saj e deri më tani arrin në 34.192.482,00 den dhe përbëhet nga:
 - 44% janë fonde të subvencionuara nga Ministria e Mjedisit
 - 46% janë fonde të dhuruara nga donatori PONT

- 7% janë fonde të dhuruara nga donatori Global Conservations
- 3% fonde vetanake.

Ashtu si parqet e tjera kombëtare në vend, institucioni funksionon me vetëfinancim, ndaj duhet theksuar se politikat e financimit të institucionit nuk synojnë përdorimin e burimeve por shërbimet e ekosistemit dhe turizmin.

Për këtë qëllim, në gusht kemi paraqitur kërkesë në Ministrinë e Mjedisit për ndarjen e fondeve në bazë të shërbimeve të ekosistemit, d.m.th. fondet financiare që subjektet e ndryshme në territorin e Parkut Kombëtar Mali Sharr i paguajnë tashmë në Buxhetin e RMV-së - në llogari të dedikuara për Ministrinë e Mjedisit dhe Pyjeve.

Ne presim që këto fonde të riinvestohen drejtpërdrejt në zonën e mbrojtur çdo vit. Në të ardhmen presim që të fokusohemi më shumë te turizmi si një nga burimet kryesore të financimit të aktiviteteve dhe hapi i radhës do të ishte zhvillimi i komponentit arsimor me qendër arsimore, përgatitja dhe zbatimi i programeve arsimore.